

## Thirrje për ofrues shërbimi \_psikolog për fëmijë dhe të rritur

<b>Pozicioni i punës</b>	Ofrues shërbimi në profilin – psikolog
<b>Data e mundshme e fillimit të punës</b>	01.03.2023
<b>Lloji i kontratës</b>	<b>Kontratë pune</b>

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontraktojë psikologë, në kuadër të zbatimit të programeve të saj në mbështetje të fëmijës dhe familjes.

Ofruesi i shërbimit do të ketë për detyrë të zbatojë në kohë dhe me cilësi aktivitetet e projektit në kuadër të ofrimit të shërbimeve psikologjike për fëmijët në rrezik të lartë dhe në nevojë për mbrojtje të menjëhershme.

### ***Rreth Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS***

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimisht NISMA ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupe më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Shërbimet mbështetëse psikologjike ofrohen nga NISMA ARSIS për të gjithë fëmijët e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë dhe në nevojë për mbrojtje të menjëhershme. Fëmijët e akomoduar në këtë shërbim referohen nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor dhe qendror. Kategoritë e fëmijëve përfitues të shërbimeve përfshijnë fëmijët në situatë rruge, viktimat të mundshme dhe ose në rrezik trafikimi, fëmijët e huaj të pashoqëruar migrant, të rikthyer, etj.

### ***Përshkrimi i Projektit***

Projektet e Nisma ARSIS për vitin 2023 vijojnë të kenë në fokus përgjatë vitit 2023 ndërhyrjen e koordinuar të shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjet vulnerabël, ku si pjesë e paketës përfshihen dhe aktivitete me ndërhyrje dhe trajtim psikologjik për fëmijët dhe të rriturit.

Projektet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara synojnë të ofrojnë cdo mbështetje psikologjike me qëllim që fëmijët/prindërit të mbrojnë /promovojnë shëndetin e tyre mendor dhe mirëqenien psikologjike.

Projektet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara, synojnë të ofrojnë mbështetje të plotë ndaj sistemit të mbrojtjes së fëmijëve jo vetëm në Bashkinë Tiranë por në të gjithë territorin e vendit.

Nën mbështetjen dhe supervizimin e plotë të kordinatorëve të projekteve, ***ofruesi i shërbimit psikologjik, do të ketë këto përgjegjësi:***

- Të kujdeset që fëmija/l rrituri, përfitues të shërbimit të trajtohet me dinjitet, respekt dhe profesionalizëm përgjatë marrjes dhe ofrimit së shërbimeve psikologjike;
- Të ketë në vëmendje çështjet e sigurisë, kujdesit dhe mosdëmtimit të fëmijës/përfituesit të rritur;
- Të intervistojë fëmijën/përfituesin, identifikojë nevojat e tyre dhe dokumentojë saktë si dhe ruan konfidencialitetin e informacionit individual sipas profilit të punës;
- Bazuar edhe në vlerësimin e profesionistëve të ekipit multidisiplinar, punonjësi merr në konsideratë rastin e fëmijës/përfituesit me qëllim ofrimin e ndihmës ndaj tyre për arritjen efektive të zhvillimit dhe përshtatjes personale;
- Të mbledhë informacione rreth përfituesit duke përdorur intervista, teknika vëzhgimi dhe metoda të tjera vlerësimi;
- Të zhvillojë plane terapeutike dhe trajtimi duke u bazuar në interesat, aftësitë dhe nevojat, në përshtatje edhe me kohën e ofrimit të shërbimit të emergjencës dhe kohëqëndrimin e rastit në këtë shërbim;
- Të këshillojë fëmijët dhe familjet duke i ndihmuar të kuptojnë problemet, të vendosin objektivat dhe të zbatojnë plane veprimi realiste;
- Të analizojë të dhëna si: shënimet gjatë intervistës, rezultatet e testeve dhe manualet e referimit në mënyrë që të identifikojë simptomat dhe të diagnostikojë natyrën e problemit të fëmijës/përfituesit;
- Të njohë dhe të zbatojë me profesionalizëm Legjislacionin e Mbrojtjes së Fëmijëve, Rregulloren e brendshme, Politikat e stafit, Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve, Politikën e Mbrojtjes ndaj Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit të Nisma, Kodit të Sjelljes, Konventën e të drejtave të Fëmijëve dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni

#### ***Kualifikimet:***

- Diplomë bachelor dhe master shkencor në psikologji;
- Kualifikime që lidhen me çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe familjeve;

#### ***Eksperiencat:***

- Të ketë experience pune mbi 3 vjet në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet shoqërore dhe punës për fuqizimin e familjeve dhe komunitetit;
- Eksperienca të mëparshme në organizata partnere të shoqërisë civile (preferohet);
- Të jetë njohës shumë i mirë i paketës ligjore për politikat e mbrojtjes së fëmijëve;
- Të ketë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe në menaxhimin e rasteve;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe nderveprimi në punën në grup;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe të gjuhës angleze;
- Fleksibilitet në punë në përshtatje me oraret;
- Aftësi shumë të mira të përdorimit të kompjuterit, paketa Microsoft Word, Excel, email, etj
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren, Brenda dhe jashtë Tiranës;
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikat të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

***Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:*** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

Psikologu\_ofrues shërbimi do të zhvillojë detyrën e tij në përputhje me Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Koventën e të drejtave të fëmijëve të nënshkruar nga NISMA ARSIS.

***Procedura e aplikimit:***

Personat e interesuar duhet të dërgojnë së bashku me kërkesën për aplikim në email:

- një kopje të jetëshkrimit profesional (CV)
- një letër interesi

brenda dates **23 shkurt, ora 16.00** në adresën [initiative.arsis@gmail.com](mailto:initiative.arsis@gmail.com)

*Ju lutemi, në vemendjen tuaj që:*

- në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: **Aplikim për pozicionin e psikologut** vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.